



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-7745 dt. 19/02/2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 26/02/2021 (e Premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.01. 2021.
2. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.
3. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020.
4. **Propozim** Vendim për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.20219, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Blllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social
5. Të ndryshme.

Drenas, 19.02. 2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 19.01.2021, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e KPF-ca, për rendin e ditës;

Të gjithë anëtarët e KPF-ca u pajtuan me rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.01.2021.
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
2. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
3. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020.
- **Rekomandohet për Kuvend**
4. **Propozim** Vendim për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360- 68569, të dt. 29.11.20219, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënie në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social
-**Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
5. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 10: 50.






Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-7586 dt. 18/02/2021

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
29. 01.2021**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **29.01.2021**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30, anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.12. 2020.
2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020.
3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:
 - a. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
 - b. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
 - c. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
 - d. Komiteti për Barazi Gjinore.
4. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .
5. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të KK të datës 29 /01/ 2021 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Nazmi Hasi, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, përfaqësues të Komiteteve Konsultative, zyra e informimit si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj se prezent në mbledhje janë 30, pjesëmarrës. Prezantoi rendin e ditës, a ka dikush diçka .

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovi** - Përshëndetje për të gjithë, ju uroj punë të mbare për vitin 2021, pasi që është edhe seanca e parë. Ne kemi edhe një ndryshim të propozim vendimit, për vendosjen e bustit të Heroit 'Asllan Fazliu' dhe do të diskutojmë pikën që do të i vije radha, për ndryshimin e vendit ku do te vendoset.

Kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës; Votojmë për rendin e ditës, u përkrah në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.12.2020.** Ka diskutime nëse jo atëherë e hedhim në votim, **pra votohet në mënyrë unanime.**

Kalojmë te pika e radhës 2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020.

Fjalën e merr Drejtori i Financave **Shyqyri Bublaku** – Kisha me filluar në pika te shkurtra me ju njoftuar pasi që e kemi pasur materialin por gjatë kohës kur është hartuar raporti dhe deri me sot i kemi dy ndryshime. Në raportin e te hyrave shuma e inkasimit është rritur d.m.th. nga **1 milionë e 480 mijë euro** me te hyra indirekte është fjala, në **1. 604.750⁹⁰ cent** që d.m.th. kemi mbledhur një buxhet diku **300 mijë euro**, më shume se buxheti i planifikuar për vitin **2020**. Ndërsa për raportin e shpenzimeve kemi dy zvogëlime te shpenzimeve ne dy drejtori komunale në atë infrastrukturës në shumën prej **1 mijë e 551 euro** dhe ne Drejtorinë për Bujqësi kjo shuma prej **1 mijë 551 euro** është ne mallra –shërbime ndërsa shuma prej **1 mijë 466⁸³ cent** është ne drejtorinë e bujqësisë dhe kryesisht ka te beje me subvencionet. Këto janë dy ndryshimet që janë te paraqitura ne raport. Raporti është hartuar me **15 Janar** ndërsa ndryshimet na kane ardhur me **27.01.2021**.

Vehbi Berisha –Unë dua te pyes për disa çështje ne lidhje me raportin këtu te faqja tre, i nderuar drejtor, me intereso i me pyet për çështjen e planifikimit kur po behet, pse po është gjithnjë e njëjta vlerë kur e dimë që është e pamundur me inkasuar te hyrat vetanake ne një vlere te caktuar sidomos ne muajt e pare te vitit kur e dimë që është e natyrshme me pas te hyra me pak , aq me tepër e dimë që ky vit nuk ka qene i lehtë për Komunën e Drenasit por as për komunat e tjera për shkak te pandemisë ku ka goditur disa resorte. Tek tabela numër dy tek realizimi i viti **2019** është një shume prej **1 milionë e 378 mijë** ndërsa këtu tek pjesa poshtë tek te hyrat nga burimet vetanake ne vitin **2019** është **1 milionë e 75 mijë**, është një mospërputhje , a është fjala këtu që janë te alokuara. Të pika tjetër , vërejta te dy drejtoritë e pashë një ulje ose mos realizim të buxhetit te planifikuar te Drejtoria e Infrastrukturës Publike është **75.47%** edhe tek kjo planifikimit urban është **71.91%**. Ndërsa te pjesa e fundit e kemi cekur ne koment. Nëse e shikojmë shumen e paraqitur ne kolonën e buxhetit te planifikuar ne shumen prej **18 milionë e 125 mijë euro** , por ne si komunë e kemi pasur të disponuar vetëm **17 milionë e 75 mijë euro** d.m.th. e kemi pasur **350.575 mijë euro** me pak.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj; kalojmë te pika e tretë , 3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:

a. Fjalën e merr përfaqësuesja e Komitetit për Barazi Gjinore:

Halide Morina – Përshëndetje edhe ne kemi përgatitur një raport vjetor ne bazë të takimeve te mbajtura nga ky Komitet. Komiteti ka mbajtur takime gjatë periudhës Janar-Dhjetor **2020**, edhe ne përgjithësi janë mbajtur një numër i konsiderueshëm i takimeve, mirëpo duke e respektuar

numrin e mbledhjeve formale te cilat duhen te mbahen. Takimi pare ka qene joformal dhe ky takim d.m.th. është mbajtur ne fillim te vitit përkatësisht me konkretisht me dt. **24.01.2020**, ku pak a shume d.m.th. ka shërbyer si një takim për njoftimin e anëtareve te komitetit dhe ka shërbyer si pike e dyte edhe planifikimi i takimeve përgjatë periudhës Janar – Dhjetor **2020**.

Më pastaj me vazhduar me gjashtë mbledhjet e rregullta te komitetit te organizuara ne periudhën Janar-Dhjetor. Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me dt. **31.01.2020**, ku normalisht secili takim ka pasur pikat e rendit te ditës edhe ne ketë takim kane qene tre pika te shqyrtuara ku është diskutuar sa i përket sektorit privat të punësimit , orarin e tej zgjatur te punësuarve e ne sektorin privat dhe diskutime te ndryshme te cilat janë lidhur me këto dy pika. Po ashtu ne secilin takim ne fund kemi me ndalur me rekomandim i cili ju është dërguar specifikisht organeve kompetente ose institucioneve përkatëse te cilat i kemi pare si te arsyeshme qe tu dërgohet një rekomandim i tille nga ne.

Mbledhja e dyte e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me dt. **06.03.2020**, po ashtu secili takim ka pasur rendin dhe pikat specifike te diskutimit dhe ne ketë takim pike diskutimi ka qene ‘Ndarja e Trashëgimisë ne Baza Gjinore’ dhe ‘Organizimi i Fushatave Vetëdisuese për të Drejtën e Femrës ne Pronën Familjare. Kemi dalë me një rekomandim qe kishte më qene i nevojshëm ndoshta organizimi i fushatave vetëdisuese për te drejtën e femrës ne trashëgimin e pronës familjare , duke u bazuar ne shoqërinë tone dhe kemi pare si te arsyeshme qe kjo do te ndikonte ne ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë dhe fuqizimin e pozitës se gruas specifikisht ne komunën tone. Si takim i tretë i rregullt kemi vazhduar ne muajin qershor te vitit **2020**, ku është mbajtur me dt. **01.06.2020** , edhe këtu kemi jep rendësi edhe fokus te veçante javës se fëmijëve dhe pjesëmarrjes se barabarte te prindërve ne kujdesin e fëmijëve. Po ashtu edhe ky takim ka rezultuar me rekomandim , ku e kemi pa si te nevojshme qe ndoshta te bëhet një organizim i pakos se veçant me aktivitete për fëmijë ne kuadër te javës për te drejtat e fëmijëve dhe te i u behet thirrje prindërve për një pjesëmarrje me të barabartë ne kujdesin e fëmijëve edhe ne ketë mënyre me ju jep mundësi qe nëse ka shqetësime specifike nga prindërit te drejtohen ne organet kompetente ose nëse shohin qe po mungon diçka ne lidhje me fëmijët e tyre. Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Barazi Gjinore është mbajtur ne muajin shtator te vitit **2020**, me konkretisht me dt. **28.09.2020** , ku ne ketë takim kemi diskutuar pak me shume rreth masave te shtyra, trajtimi që ju behet moshave te shtyra dhe ndoshta disa hapësira specifike që të frekuentohen specifikisht nga këto moshë. Përveç hapësirave ekzistuese ne komunën tone qe janë te shumta dhe tepër mire te shfrytëzueshme e kemi pa te veçante edhe nevojë qe , ndoshta shpesh here moshat e vjetra sidomos gjinia femërore si pre e paragjykimeve mungon edhe te dalja ne hapësirat publike dhe pse jo me qene një hapësire specifike rekreacioni qe mundet me u shfrytëzuar nga këto moshë. Mbledhja e pestë e rregullt e KKBGJ është mbajtur ne muajin Tetor te vitit **2020** me dt. **14.10.2020**. Këtu si pike diskutimi kane qene krijimi i aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese rreth kancerit te gjirit meqenëse është edhe muaji i dedikuar specifikisht kësaj sëmundje , zbulimit të hershëm dhe trajtimi i grave te prekura nga kjo sëmundje me diskutime të ndryshme të lidhura me ketë temë. Po ashtu kemi rezultuar me një rekomandim qe ka qene organizimi i aktiviteteve për fushatë vetëdisuese në përkrahje të grave te prekura nga kanceri i gjirit dhe gjithashtu të behët një thirrje për një pjesëmarrje me te madhe te gjinsë mashkullore ne këto fushata qe ti u ofrohet mbështetja e duhur femrave qofte edhe vetëm mbështetje morale. Po ashtu mbledhja e gjashtë e rregullt KKBGJ ka ndodhur ne muajin tetor të vitit **2020**, me dt. **29.10.2020**. Edhe këtu kemi diskutuar rreth aplikacioneve te punësimit edhe konkurseve që hapen e sidomos në terminologjinë qe përdorën ne këto konkurse , sepse sidomos ne fushën e edukimit shpesh here kemi hasur qe kërkohet edukatore ose mësuese por gjithmonë

një farë forme në shikim të pare gjinia mashkullore ka qenë paksa e lenë anash në këto aplikacione dhe në kemi parë të arsyeshme që të diskutohet për këtë dhe të nxirret një rekomandim që në këto aplikacione të sugjerohet të mos përdoret një terminologji e cila paraqet pa barazi gjinore edhe zakonisht sidomos në çerdhet shtetërore gjenden këto shprehje që kërkohet një edukatore ose një mësimsdhënëse edhe që automatikisht në mënyrë të pavetëdijshme e krijon një farë përjashtimi të gjinisë se kundërt të aplikojnë në këtë drejtim , edhe ky rekomandim ju është drejtuar organeve dhe institucioneve kompetente të cilat në i kemi pa të arsyeshme. Faleminderit për vëmendjen , a ka dikush pyetje , nëse ka unë jam e gatshme ta dëgjojë me vëmendje.

Vehbi Berisha – Faleminderit shume e nderuar për këtë raport, po ashtu i përshëndes edhe kolegët e juaj që kanë me raportuar për raportet e tjera. Në fakt i kam shikuar të gjitha raportet, ndoshta edhe nuk keni qenë informuar , por në kemi pasur një situatë pak a shume të ngjashme tek raporti i auditimit edhe raporti i auditimit që behet një herë në vit nga zyra e auditorit të përgjithshëm , na jep rekomandime , edhe ato rekomandime Komuna e Drenasit ka filluar me i listuar shume mire dhe përpos që i liston në forme tabelorë edhe i adreson , a është duke u përfill ai rekomandim, a është duke u zbatuar , kush është duke u marre me atë punë. Edhe këtu të gjitha raportet e pashë një mungese të listimit të tillë që të dihet a janë duke u zbatuar këto rekomandime , ndoshta herën e ardhshme kishte qenë mire me u aplikua një shembull i tille. E keni modelin tek raporti i auditimit.

Nexhmedin Bala- Unë i përgëzoje të gjitha komisionet i lexova me vëmendje të gjitha raportet. Raportet janë të përpunuara në mënyrë të saktë dhe po duket një punë serioze që janë duke e bërë dhe po e kuptoj rolin e komisioneve. Aty ku u ndërlihdh kolegu jone është mungesë e kompetencave të komisionit dhe nëse në ju kërkohet me i listua dështimet e qeverise , ata nuk e kanë kompetencën e tyre, janë organ konsultativ. Por këtu po e arsyetojë kolegun tim në atë aspektin që ti keni parasysh këto rekomandime të tyre se me të vërtete e kishin bërë një punë të shkëlqyer të gjitha komisionet pa ndarë njëra prej tyre , dhe ajo që me pëlqeu sot e pashë për herë të parë një reagim publik me i mbrojtë gjininë mashkullore.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci** – Unë i përgëzoje për punën e tyre edhe për rekomandimet , nuk po dua me i shtua fjalës se zotit Bala, por komitetet duhet me e pas një plan të vetin edhe kur na i bëjmë dëgjimet publike kur ka implikime të rekomandimeve të tyre në buxhet më ardhur edhe me i shpalosë gjatë dëgjimeve publike që do i bëjmë verën që do të vjen sepse asnjë rekomandim e tha zoti Bala që këta nuk mundën me i mbikëqyrë rekomandimet dhe me na urdhëruar me kryer ndonjë rekomandim të tyre për arsye së mund të ketë implikime buxhetore , kur ka implikime rekomandimet nuk vlejné sepse askush nuk shkon në burg për juve. Pra ju ftoj në dëgjimet publike, në bëjmë lajmërimin pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara ku i bëjmë takimet nëpër lokalitete, por edhe takimet e tjera që ju të vini të merrni pjese dhe të propozoni dhe të ju dëgjojnë edhe qytetarët e tjerë për propozimet e juaja që ta lejojnë edhe ata miratimin apo jo në buxhet të rekomandimeve.

Fjalën e merr **Nexhmedin Bala** – Rekomandimet e tyre ishin shumica pa implikime buxhetore më sa isha i qarte që rekomandimet e tyre vlejné për ekzekutivin e Komunës së Drenasit. I kam lexuar raportet e tyre janë rekomandime shume profesionale. Unë bëra apel që me u përfill rekomandimet e tyre se ishin profesionale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj. Fjalën e kalojmë tek:

b. Komiteti për Persona më Aftësi të Kufizuara. Fjalën e merr përfaqësuesja e KKPAK-së Arjana Isufi – Përshëndetje për të gjithë. Sikur se edhe vitin e kaluar edhe në këtë vit kemi përmbledhur një raport për punën dhe aktivitetet të cilat kemi arritur të realizojmë përgjatë një viti. Komiteti Konsultativ për Persona më Aftësi të Kufizuara ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe më shumë se tetë takime të tjera konsultative në të cilat kemi specifikuar ide edhe përvoja të veçanta. Mbledhjet formale zakonisht i kemi mbajtur në zyrën pranë bufesë në Komunën e Drenasit, kurse mbledhjet e tjera konsultative i kemi realizuar në terren dhe sipas rastit. Krahas planit të punës si grup avokues kemi dhënë prioritetet, kemi identifikuar një seri nevojash për ndryshim për të mirën e kësaj kategorie apo këtij komuniteti, kemi nxjerrë rezultate, kemi ngrit rekomandimet të cilat me pas janë diskutuar e shtjelluar më personat kompetent. Ju kemi mbajtur më përpikmëri udhëzimit administrativ më të cilin veprojmë lidhur më punën dhe aktivitetet tona. Kjo gjithmonë duke mbajtur të informuar Zyrën e Kuvendit Komunal më procesverbale të mbledhjeve të rregullta, raportet tre mujore si dhe takimet e realizuara më Kryesuesin e Kuvendit Komunal.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci** – E vlerësoj shumë punën që e keni bërë sidomos bashkëpunimin që keni pasur më Drejtorinë e Arsimit, ju përgëzoj ato rekomandime, vërejtje të drejtorive apo institucioneve tjera që lidhen më komunën do të marrim, dhe do të marrim masa ndaj atyre zyrtarëve që nuk kanë pasur bashkëpunim më juve.

Petrit Gashi – Përshëndetje për të gjithë në veçanti për përpiluesit e këtij raporti, është një raport i përmbledhur tepër mire. Atëherë se pari dua të ju falënderoj për një raport të bërë mjaftë mirë dhe që është një model raport edhe për të tjerët, jo vetëm në kuadër të rekomandimeve që jepen për institucionet e nivelit komunal por edhe në kuadër të bashkëpunimeve që ju i keni bërë më institucionet, gjithashtu rekomandimet do ta ndihmojnë jo vetëm neve si asambleistë për të ngritur çështjet që kanë të bëjnë më këtë kategori por më një fare forme sensibilizon opinionin por edhe institucionet për ndihme ndaj jush. Unë ju falënderoj shumë që një raport të tillë e keni dhënë model për neve mirëpo ka treguar se edhe në këtë vit pandemie, vit të cilin është vështirë të punohet, e keni bërë një punë të mrekullueshme prandaj ju falënderoj shumë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, Fjalën e kalojmë tek:

c. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. Fjalën e merr përfaqësuesi i KKAKRS-së. Gëntrit Mulaku – Gjatë këtij viti Komiteti Konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport ka mbajtur mbledhjet e parapara ku për shkak të pandemisë së krijuar, ne mbledhjen e parë e kemi mbajtur online. Kemi hartuar planin për vitin 2020, kemi ndarë detyrat dhe përgjegjësitë të secilit anëtarë të Komitetit. Po ashtu në këtë periudhë kemi identifikuar OJQ-të e fushave të kulturës dhe sportit që veprojnë në Komunën e Drenasit. Takimin e dytë e kemi mbajtur më të gjithë artistët e fushës së kulturës në Komunën e Drenasit ku ndër ta kemi diskutuar në këto pika: funksionimi i grupeve artistike të ndryshme në Drenas, organizimin e festivaleve në Komunën e Drenasit dhe rëndësia e tyre. Funksionimi dhe zhvillimi i artit pamor në Drenas, mundësitë për aktivizimin e teatrit të qytetit në Drenas, zhvillimin e politikave kulturore në Drenas. Përvëç

kësaj në kemi bërë edhe një anketim ku e keni në shtojcën (a). Takimin e tretë e kemi mbajtur më sportist dhe udhëheqës të klubeve të Drenasit , ku ndër të tjera kemi diskutuar në këto pika të rendit të ditës: funksionimi i klubeve sportive në Komunën e Drenasit ,organizimin e aktiviteteve sportive gjatë periudhës së pandemisë, idetë për zhvillimin e politikave sportive në Drenas , mundësia e aktivizimit të klubeve sportive olimpike që i mungojnë Komunës tone si atletika gjimnastike ,xhudo etj. Po ashtu kemi bërë një anketim ku e keni në shtojcën (b). Takimin e katërt e kemi mbajtur më udhëheqës të OJQ-ve, më rini dhe të gjithë aktivistët e Rinisë. Ku kemi diskutuar për nevojat e të rinjve në komunën tone , ndikimi i pandemisë COVID-19 në organizimin e aktiviteteve rinore në Komunën e Drenasit, KVRL-ja plani organizativ dhe nevojat që ka kjo organizate po ashtu punimi i OJQ-ve me shkollat e mesme , fillore ne komunën e Drenasit , ku njëkohësisht kemi bere një anketim ku ketë anketim e keni në shtojcën (c).Takimin e pestë e kemi mbajtur më drejtorin e drejtorisë komunale të arsimit zotëri **Muhamet Gjoka** , ku në takim kemi diskutuar në këto pika të rendit të ditës: sfidat e organizimit të mësimin në kohën e pandemisë, pajisjen e shkollës me mjete konkretizuese , nxënësit më nevoja të veçanta , sfidat dhe përkrahjet e tyre , rekrutimi i mësimitdhënësve të rinj , konkurset etj. Takimin e gjashtë e kemi mbajtur më Kryesuesin e Kuvendit Komunal zotëri **Labinot Halilaj** , ku në këtë takim kemi diskutuar për punën një vjeçare të **KKRAS** si dhe i kemi dorëzuar rekomandimet për vitin **2020** . Bazuar në kompetencat ligjore të gjitha rekomandimet kanë dalë pas hulumtimit që kemi bërë më anëtarët e Komitetit si dhe më takimet e drejtpërdrejta më mësimitdhënës, drejtor shkolla, prindër ,nxënës, student , sportist , udhëheqës të klubeve sportive , udhëheqës të asambleve që funksionojnë në komunën tonë dhe kemi rekomanduar për të gjitha drejtoritë.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci** – E vlerësojë komitetin e juaj për punën që e ka bërë , shpresoj që rekomandimet që i keni përmendur janë tashmë të realizueshme. Ne ju dhëmë bursa nxënësve të dalluar sepse ata aplikojnë për bursa. Sa i përket artistëve që nuk ju kemi dhënë mirënjohje ose që nuk i kemi shpallë artist brenda komunës në e kemi një shpallje publike që e bëjmë për çdo vit në fund të vitit nëse nuk gaboj dhe duhet dikush me i propozua ata që komisionet më mund me i vlerësuar. Nuk është që i kemi lenë anash nuk është e vërtetë se jo vetëm sportistët por edhe artistët i kemi vlerësuar edhe kujt do qoftë tjetër por kur nuk ka propozime ne nuk mund të mendojmë diçka, ju mundeni më propozua shoqata tjera. Sa i përket teatrit nuk behet teatri në Drenas , ne kemi dëshirë, por nuk lejohen mundësitë , buxheti është veç për gjashtë komunat më të mëdha dhe nuk kemi as një mundësi më bërë teatro për shkak se numrin e punëtoreve të atij teatri ose anëtarët e atij teatri nuk kemi mundësi me i paguar dhe nuk na lejon niveli qendror grand për pagat e tyre. Sa i përket sallës ose vend caktimit për objektin e shigjetarisë janë shuma specifika që duhet me i caktua sepse shigjetaria nëse është në kuadër të nivelit të komunës edhe menaxhohet nga ai sigurisht mund te jepet prona edhe mund të bëhet me donatorë por edhe më buxhet tonin por më qene ekipi privat ne nuk mund ti japim pronë , nuk mund ti ndërtojmë objekte.

Petrit Gashi - Pra edhe për këtë raport ju përgëzoje shume ose nga pyetjet ose dilemat e ngritura morëm përgjigjë Unë jam një pasionat i madh i hulumtimeve sidomos në terren dhe

nëse i keni bërë tre hulumtime më mirë do të më qenë pjesë e rezultatit dhe pjesë e të gjeturave të këtij hulumtimi këtu brenda këtij raporti. Ju po thoni që ne i kemi përdorur në kuadër të rekomandimeve që janë dhënë nëpër sektor të caktuar por ne nuk e dimë sepse nuk i kemi parë këto rezultate dhe kështu më një fare forme neve na dërgoni në lajthitje se ato rekomandime kane dalë për hulumtimin në ndërkohe që ne nuk i kemi rezultatet e hulumtimit. Pra është dashtë që rezultatet e hulumtimit tek këto tri hulumtimeve që për mua janë zakonisht shume dhe janë të mirëseardhura në këto tri fushat ,të jenë pjesë përbërëse të këtij raporti.

d. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Fjalën e merr përfaqësuesja e KKZHEMASHMS.

Fitore Sefiu - Përshëndetje për të gjithë. Për të gjithë ishte një vit i vështirë, edhe ne si komitet kemi pasur vështirësi në arritjen e qëllimeve tona. Kemi pasur gjashtë takime formale dhe tre takime joformale. Takimet gjithmonë janë thirrur nga Kryesuesi po ashtu edhe nga anëtarët e komitetit. Ne takime kemi pasur të ftuar drejtorë të dikastereve të ndryshme si; Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Arsim Haxhiu , kryetarin e komunës z. Ramiz Lladrovci , Shtabin Emergjent për Menaxhimin e Pandemisë COVID-19 ,Drejtoreshën për Shërbime Publike Emergjente zonjën Lumnije Krapit , si dhe vizita në kopshtin ‘Ardhmëria’ në Drenas. Gjatë vizitës në qendrën për punë sociale ku u mirëpritëm nga drejtori i kësaj qendre z. Ragip Dervishi , vizitë në qendrën për punë sociale në takim më z. Elmi Dobra. Gjatë këtyre takimeve kemi dhënë rekomandime si gjatë diskutimeve po ashtu edhe më shkrim e të cilat gjithmonë janë marrë parasysh. Po ashtu kemi marrë pjesë në aktivitetin për shënimin e ditës ndërkombëtare të mjedisit të organizuar nga Komuna e Drenasit përkatësisht nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente. Për punën tonë është njoftuar edhe opinioni publik përmes faqes që kemi hapur në njërin nga rrjetet sociale nga e cila kemi shqyrtuar edhe disa probleme që qytetaret na kane njoftuar përmes saj. Pavarësisht se ishte një vit i zymte shkaku i pandemisë , aktivitetin tonë e karakterizua më punë vullnetare në kopshtin ‘Ardhmëria’ duke siguruar donatorë për perde të errësuarra dhe për mbyllje të vitit kemi bërë aktivitetin për shpërndarjen e dhuratave për fëmije më organizim nga Drejtoria e Ekonomisë dhe e Biznesit që operojnë në komunën tonë. Duke besuar se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi , duhet edhe me shume të inkurajojmë projektet qe për qellim kane përmesimin dhe mirëqenien sociale për banoret tanë.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz LLadrovci** – Edhe raportin e juaj jam jashtëzakonisht i lumtur qe e keni bërë shumë të mire dhe ju përgëzoj për punën.

Petrit Gashi – Ashtu si raportet paraprake edhe ky është një raport i mire , megjithatë ndoshta edhe për shkak të një viti tepër sfidues për të pare më shumë specifika ka qene i rendë sidomos për komunën tone qe e ka goditur në dy sektor të rëndësishëm në atë te zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale ,e di që puna e juaj në raport më këto kategori ka qenë pak më sfiduese së e të tjerëve për shkak te kërkesave të shumta qe ka prodhuar viti **2020**. Megjithatë unë ju përgëzojë

për vullnetin , dëshirën , për bashkëpunimin që e keni pasur më institucionet në mënyrë që sot të kemi një pasqyre të qartë të aktiviteteve të juaja.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj kaloim të pika e katërt : 4. Propozim
Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci** – Tashme e dini që shtatorja e Heroit ‘Asllan Fazliu’ është ndërtuar ose është në proces përfundimi i ndërtimit dhe pas një kontakti me familjen , para disa javësh kemi diskutuar këtë problem për vendosjen e shtatores. Meqenëse marsi është muaji te cilin ka rënë heroit , unë kam marre masa te shpejtuara për me e gjet lokacionin. Ne momentin qe ne kemi gjetur lokacionin i kemi njoftuar , ata e kane dërguar një letër për te cilën kane thënë qe nuk do te ishim te kënaqur si familje por do te diskutonim dhe unë i kam thirrur ne takim dhe jam takuar , i keni te gjitha shkresat. Jam takuar me familjaret , me vëllain e tij , me djalin e heroit edhe me nipin e heroit ose ish-kryetarin e veteraneve te luftës z. Faik Fazliu. Kemi diskutuar gjate unë prej kohësh e kam propozuar që shtatorja të vendoset ne pjesën ku do te shtohet sheshi dhe i kam njoftuar qe për muajin mars kjo nuk mund përgatitet , por brenda dy-tre viteve do ta ndërtojmë sheshin dhe aty mund ta vendosim. Pra ata kane renë dakord dhe kane thënë ne presim dy-tre vjet derisa te rregullohet sheshi , pra e keni parcelën , mos e merrni numrin ose piken ku e keni ne dokumente sepse brenda parcelës do te lëvizte për arsye se aty do te vendosen edhe shtatore tjera. Ju e keni një hartë përpara ku ne po mendojmë që ta zhvillojmë projektin e tunelizimit te rrugës prej ish shtëpisë se mallrave apo objektit te AL Trades e deri te rruga ku e lidh me rrugën Xhevat Demaku do e fusim krejt ne tunel dy kahje dhe brenda tunelit do te ketë parkingje te automjeteve. Ne do ta qesim si kriter për kompaninë e cila do ta merr atë pjesën qe e kemi paraparë me dhënë me koncesion që gjithë prona te jetë parking nëntokësor i cili do te jetë ne shfrytëzim te komunës. Pra do te lidhët gjithçka me tunelin edhe me parkingjet qe ne të ja u lehtësojmë qytetarëve tonë te kanë parking te mjaftueshëm , sepse ju po e dini qe te gjitha janë gjelbërim. Ne kemi bisedua edhe në tema tjera kemi biseduar edhe me Petritin qe të vendosim edhe disa shtatore në segmentin prej 222m, ku përfundon sheshi ne drejtim të rrugës **Shaban Shala** deri te **Raiffeisen Banka** deri ne atë segment. Unë ju ftoj që ta votoni sepse kjo do te merr kohë për ndërtim dhe ti heqim te gjitha keqkuptimet kujt do qofshin. Familja janë shumë të lumtur për këtë vendim ka qene propozim i imi , i tyre ka qenë në tre vende lokacione: te qendra tregtare , ka qene ne oborrin e komunës se re dhe oborrin e komunës se vjetër , i kemi shpjeguar qe këtu nuk ka mundësi dhe i kemi shpjeguar që edhe në oborrin e komunës se vjetër do ti largojmë dhe do ti vendosim ne një vend shume reprezentativ qe ai do jete sigurisht sheshi Fehmi LLadrovci. Pra ju thashë mos e merrni piken kuqe sepse ne kemi menduar pak me ndryshe , nuk e kemi pastruar mire ne fotografi. Kisha kërkuar qe me përmisua fotografinë edhe me ja u pru te gjithëve qe me e pas me përmisua, do te jetë brenda asaj parcele sa me afër bankave ose sa me afër atyre objekteve, sepse një shtatore qe do të vendoset tre metra , objektet do te jenë me te vogla qe me mund me u dok ma mirë. Ndërsa në pjesë te tjera do ti propozojë Petriti.

Petrit Gashi – Vet fakti që bëhet propozim vendim për vendosjen e një shtatore të heroit kombëtar ngjallë emocion, sigurisht që vendosja e këtyre shtatoreve ka pasuruar Komunën e Drenasit si dhe vendosja e shtatores ‘Asllan Fazliu’ dhe në proces shtatorja tjetër Ymër Alushani në Komoran është një lajm i mirë për të gjithë qytetarët e Drenasit. Po ashtu siç jemi pajtuar unë mendoj që lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë dhe këta heronjë janë simbolika më mirë e kombit tonë që kanë dhënë më së shumti për kombin tonë, mirëpo luftën e kemi bërë me partner të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë dhe është mirë që brenda këtij sheshi për të pasuruar edhe më shumë këtë shesh të propozohen dy njerëz të cilët e kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë çlirimin e vendit dhe lirinë e vendit dhe dy të tjerët që e kanë ndihmuar shpalljen e pavarësisë dhe shtet ndërtimin e Kosovës është fjala për vendosjen e shtatores së **Bill Klintonit** dhe **Toni Blerit**, si dhe dy njerëzit e tjerë protagonistët kryesore të çlirimit të vendit si **George W. Bush** dhe **Angela Merkel** të cilët e kanë sjelle pavarësinë dhe shtet ndërtimin te saj por nuk do të harrojmë asnjëherë gjeneratat e tjera që kanë sakrifikuar për vendin dhe në këtë rast besoj se pajtohemi të gjithë së do të ishte mirë që Drenasi ta përfaqësojë edhe një shtatore të cilat për mua ngjalle emocion dhe për secilin e sidomos për gjeneratat e vjetra është fjala për shtatoren e Adem Demaçit, ikonës së madhe. Mandelit të Evropës dhe njeriut i cili ka qene dora e hekurt e shtyrjes së lëvizjes tonë përpara për lirinë dhe pavarësinë e vendit, pra këto janë propozimet tona edhe në konsultim me kryetarin dhe kërkoj mbështetjen e secilit prej jush në mënyrë që ta pasurojmë sa më shumë vendin tonë.

Nexhmedin Balaj – Unë kam një sqarim vetëm nga aspekti teknik sepse në material na është ardhur propozimi i vjetër që ka qene, dhe në aspektin teknik të jetë procedurë dhe mos krijohet konfuzitet, ky propozimi i vjetër nuk nevojë hiq të jetë material por është propozimi i ri dhe të qitet në votim, të jemi te qartë të mos të manipulon dikush me tha unë kam pas një propozim dhe kam menduar që kam votuar për këtë propozim.

Ramiz LLadrovci - Shume e sakte z. Balaj e kanë marrë të gjithë këtë propozimin asamblistët ose shumica por edhe numri i protokollit është i njëjti d.m.th. propozimi i fundit për të cilin folëm e kemi futur edhe në rend të ditës vend lokacioni do të ndërrohet, edhe po e përsërisë edhe një herë, në sheshin, pjesën e sheshit dhe sheshin e vjetër do ti ndërtojmë më mjetet të cilët i ka fituar komuna si rezultat i performancës dhe me mjetet që i kemi ndarë për këtë vit që janë diku rreth 300 mijë euro. Sigurisht që do të jetë projekt dy ose tre vjeçar e në qofte së bëhen të gjitha llogaritë na del shuma më e madhe, ne do ta rrisim për vitin tjetër edhe për vitin 2022 dhe 2023.

Beçir Kiqina – Përshendetje për të gjithë. Kisha dashtë me u ndërlidhë sa i perket çështjes se vendosjes së shtatoreve. Vendosja e shtatoreve të gjithë e dimë që për luftën e UÇK-së edhe gati secili prej nesh jemi të prekur nga lufta e fundit ku kemi dhënë kontributin familjar aq sa kemi mundur dhe sot i vuajme edhe pasojat e asaj luftë. E dime që historia në qofte së harrohet ajo përsëritët edhe shumë shtatore janë vendosur në sheshin **Fehmi Lladrovci** dhe nuk kemi mundur të votojme kundër për arsye se kjo drejtpërsedrejti ndoshta i kishte rënë së mund të jemi kundër herojnve ose dikujt. Por sa i perkët kolegut i cili tha që duhet me shtua edhe shtatore tjera në shesh unë mendoj që nuk guxojmë ne të e teprojmë edhe më figura të tjera ndërkombetare edhe

vendorë për arsye se Drenasi nuk është Kosova. Drenasi është vetëm një komunë e vogël e Kosovës , edhe unë mendoj që të gjitha vlerat e lirisë për të gjithë kontributin e ndërkombëtareve të gjithë ata duhet ti vlerësojme dhe duhet të ngrisin një muze të caktuar të cilin e financon atë komuna në bashëpunim me qeverinë edhe me donatorët dhe si është më së miri dhe në atë muze të ketë monumente , argumente ku mund të shkojnë të tjeret dhe ti shikojnë dhe jo këto gjitha shtatore në një komunë aq të vogël siç është Komuna e Drenasit , por jo duke e keqkuptuar këtë fjalim timin se askush nuk mendoj së është kundër vlerave të lirisë, kundër heronjve dhe kundër ndërkombëtareve të cilët kane ndihmuar në çlirim e Kosovës.

Petrit Gashi – Këto unë i kam dhënë si propozime e thashe që lufta çlirimtare nuk ka qenë vetëm luftë e UÇK-së por në partneritet të përhershme me komunitetin ndërkombëtar e në veçanti me dy partnerët më të rëndësishëm të kohës së çlirimit që ka qenë **Britania e Madhe** dhe **Shtetet e Bashkuara të Amerikës** dhe dy ikona të mëdha siç kanë qenë **Bill Clinton** dhe **Toni Bleri**. Megjithatë ju thatë i nderuar koleg asambleist së Drenasi nuk është Kosova por Drenasi është e vertete qe nuk është Kosova por është zemra e Kosovës dhe mendoj që në zemren e Kosovës duhet të investohet dhe duhen të vihen elemente përbërse të cilat në bashkësinë ndërkombëtare do të reflektojnë pozitivisht dhe një pasqyrë e qarte pra për një lloj falenderimi dhe mirënjohje për ata që na kanë ndihmuar në luftën e tonë të drejtë.

Beçir Kiqina - Të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për lirine e Kosovës duke përfshirë këtu ndërkombëtares **Bill Clintonin** dhe **Ton Blerin** të gjithë ata duhet ti vlerësojmë dhe mendoj qe i ka vlerësuar edhe kryeqyteti i **Republikës së Kosovës** duke ngritur monumente dhe duke emëruar shumë rrugë por unë thashë që mundemi me bo folklor më thëne Drenasi është zemra e Kosovës se është e vertet që ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për lirine e vendit , por duke u munduar shume më i bërë këto sende të mëdhaja ndonjëhere po dalim jashtë kontekstit edhe historik se nuk mund ta bëjme Drenasin sikur Maqedoninë ose Shkupin. Kështu që besoj se kur kemi biseduar më herët që edhe ti e ke pasur të njëjtin mendim kështu por sido që të jetë shpresoj se ata të cilet e meritojne gjithë herë me u përmend dhe më u përkujtuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj – Unë e kisha përkrahur në këtë rast z. Gashi, nuk e di pse po ju mendojnë aq shumë shtatore , nuk ka pse me ju mundu që kaq shume vendosja e shtatoreve. Diçka që është histori e lavdishme e popullit tonë nëpër të cilin kemi kaluar të gjithë ne edhe nëse të tjerët nuk kane vullnet më vendose , kryeqyteti i Kosovës Prishtina nuk ka shtatore të **Adem Jasharit**. Duhet të jemi të privilegjuar që në kemi këso shtatoresh edhe që duhet me i pas të ardhmen. Historia për dikën shumë shpejt po harrohet. Kur flitet për shtatore e heronjve qoftë vendorë edhe ndërkombëtar **Bill Klintoni** është një hero i gjallë i çështjesh shqiptare , i çështjesh së Kosovës, hero i gjallë. Nëse ne duam më nderua figura të tilla atëherë ne vetëm vetën e nderojmë.

Sokol Bylykbashi – Sa i përket propozimit për shtatoren e heroit ‘Asllan Fazliu’ këtu ka diçka të paqartë dhe kjo paqartësi u rrit me faktin kur na u soll një dokument pak pa filluar mbledhja , dokumenti cili e ndryshon vend ndodhjen e planifikimit për vend ndodhjen e shtatores. Këtu

është bere një gabim në hapa dhe për këtë unë nuk mundem me dhanë një vote 'Për'. Si mundemi më marrë vendim saktësisht ku ka më qenë , ku ka me u vendosë shtatorja e heroit në fjalë kur ne ende nuk kemi parë një plan për zgjatimin e sheshit , nuk ka plan , nuk kemi parë kurrë fare plani i cili na tregon se si duket sheshi më atë pjesën e zgjatur edhe na tregon koston e investimit , edhe na e tregon afatin e realizimit të atij plani. Si mundesh më e vendos pikërisht në atë pjese ku mendohet te bëhen të gjitha këto punime me vendosë për vendosjen e një shtatoreje të një heroit të madh kur paramendohet së paku verbalisht më u bërë të gjitha këto punime për të cilat po foli , nuk ka kurrfarë plani. Ky është vendim pezull keni parasysht pasi qe në këtë vit përfundon mandati dhe fillon mandati tjetër qeverisës katër vjeçar dhe gjithë ky vendim më duket mua pezull , i ngutshëm jo duke i pasur parasysht hapat. Hapi i parë kishte më qenë me na e prezantuar diçka pastaj nëse vendoset ,nëse ka buxhet shkon në realizime. Kjo është krejt në fund.

Adem Bucolli – Përshëndetje për te gjithë. Z. Kryetar së pari të përgëzojë për të gjitha vendimet që ke marrë deri tash në bashkëpunim më neve më përkrahjen tonë. Ato kane qenë propozime të juaja për vendosjen e shtatoreve të heronjve të cilët edhe botërisht njihen dhe lufta e shenjte e UÇK-së. Kur është në pyetje për shtatoret atëherë ne jemi para një akti të kryer, mundem ta quaj akt i kryer se askush nuk është kundër dhe besoj që asnjë shqipëtar nuk është kundër shtatoreve. Po më vjen mire edhe ideja e zgjerimit të sheshit ku kemi mundësi vendosjen e shtatoreve të tjera. Unë desha me shtua edhe kolegun tim z. Gashi. Keni bërë mirë që e ke dhënë këtë propozim por unë e kam edhe një propozim me shtua për të ti vendosjen e shtatores së **Wesley Clark** , është ai qe e ka urdhëruar **NATON** edhe shenjën e **NATOS** për me e bombarduar një agresor të cilin e kemi pasur më shekuj të tërë armik. E kam edhe një propozim nëse me lejohet pasi qe është më propozime se si Komunë e Drenasit kemi mjaft dëshmorë dhe të gjithë janë dëshmorë më e bërë një projekt arkitekturorë, një propozim arkitekturorë për vendosjen e të gjithë emrave të dëshmorëve të Komunës së Drenasit që me i përfshi të gjithë dëshmorët në sheshin '**Fehmi Lladrovci**'.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz LLadrovci - Wesley Clark** është i emëruari i **Bill Klintonit** ose i **Gerorge Bushit**. E thamë që dy liderët më të rëndësishëm të botës siç është **Bill Klintoni dhe Toni Bleri** kanë vendosë ose ja kane imponuar krejt botes demokratike më e bombarduar Serbinë për shkak të gjenocidit ndaj Kosovës. Ndërsa dy liderët botëror siç është **Georgë Bush** dhe **Angela Merkel** kanë vendosë edhe datën e ditën e Pavarësisë së Kosovës , kështu që e meriton Drenasi. Siç e tha edhe zotëri Petriti zemra e Kosovës aty ku janë nis aksionet e para të UÇK-së dhe aty ku një fare mënyrë kanë përfunduar aksionet e **NATOS** dhe të UÇK-së me lirinë e Kosovës dhe më Pavarësinë e Kosovës.

Bedri Nika – Përshëndetje për të gjithë. Unë dola këtu që ta mbështet vendosjen e shtatores së heroit '**Asllan Fazliu**'. Janë shtatore të mirësearchura të gjithë heronjve tonë por kur behët fjalë të propozimi i kolegut tim asamblist z. **Petrit Gashit** për vendosjen e shtatoreve të mbështetësve të Pavarësisë së Kosovës është e pakuptimtë ti vendosim shtatoret e burrë shtetaseve miqve të **Ibrahim Rugovës** dhe të mos vendosim shtatoren e Presidentit historik **Ibrahim Rugova**.

Kështu që ndër një propozimet e para para të gjitha propozimeve tjera është propozimi për vendosjen e shtatores së Presidentit historik **Ibrahim Rugova** që i bën ndër Kosovës , i bën ndër edhe Drenasit pasi që ne jemi mesi i Kosovës. Kështu që asnjë propozim tjetër është i pavlefshëm. Nuk besoj që kanë më pranua as miqtë tanë në rast se nuk e respektojmë dhe nuk e vendosim shtatoren e Ibrahim Rugovës.

Fjalën e merr Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj – Lufta e UÇK-së e ka pasur edhe një njësi që është njësi 111 brigada Adem Jashari Tigrat e zi edhe fatbardhësisht ajo njësi ka vepruar në territorin e Komunës së Drenasit ka qenë njësi më elite e **UÇK-së** nuk mundet me e mohu askush. Patjetër duhet që Drenasi ta ketë një shesh më emrin Brigada 111 Tigrat e Zi Adem Jashari por më patjetër është e pakuptimte nëse emërojmë shume sheshe dhe nuk e kemi një shesh të këtillë. Pa marre parasysh vlerën edhe luftërat që janë dëshmuar prej asaj njësie dhe në përkrahje të shumë njësive tjera.

Vehbi Berisha – Ne diskutuam gjerësisht për këtë temë po besoj që askush prej neve nuk është kundër shtatoreve. Por ajo që desha të them që në fillim kjo punë është nisur keq. Pse u nis keq? Nuk jemi kundër shtatoreve po sa e patë për pak minuta këtu linden menjëherë njëzet propozime. Por paramendoni më e qitë një sondazh diku në publik paramendoni që edhe dyqind shtatore minimumi na dalin. Ne jemi dëshmitare se si pasojë e vendimeve të ngutshme që më vendos sa me shumë buste , shume familje kanë qenë të hatëruara dhe janë ndjerë të fyer konkretisht edhe këta zotërinjtë e familjes së heroit ‘Asllan Fazliu’. Mua personalisht më kanë kontaktuar edhe i kanë shprehur shqetësimet e tyre që kanë qenë fillimisht kundër këtij lokacioni të parë. Po më vjen mirë që janë pro lokacionit të dytë kanë arritur një marrëveshje. Të gjithë kanë qejf me i vendosë në vende meritore. Vend meritor Drenasi ne dimë se çfarë hapësire ka , e kemi një shesh se nuk kemi ka me e ndarë , nuk kemi ka më e ndarë aq hapësirë kemi, veç të rimodelojmë një qytet tjetër , të bëjmë një qytet tjetër dhe të qesim një hapësirë nga fillimi. Të gjitha këto kërkesa po mendojë që përsëri kemi me pas njerëz të pakënaqur ,përsëri kemi më pas problem , përsëri kanë me u ndjerë të hidhëruar dhe të fyer disa familje të dëshmorevë të cilët edhe ata kanë dëshirë me i vendosë familjaret e tyre , heronjtë e tyre dhe të tonët në vende meritore. U dashtë me u mëndu sinqerisht për këtë punë.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci** – Zotëri Berisha mos i ngatëroni gjerat , fjalimin tënd e ke ngatërruar ju thatë që familja u ankua edhe se ka pranuar nëse ti nuk harruar , unë në përvjetorin e ‘Asllan Fazliut’ edhe më rastin e fillimit të ndërtimit të shtatores , kam thënë që në bashkëpunim më familjen do ta vendosim në një vend meritorë mos tento me u bërë i mirë sepse përsëri po bëhesh i keqi sepse po thua nuk bën më vendos shtatoren e ‘Asllan Fazliut’ aty. Pra kur kanë thënë që shtatorja ka përfunduar dhe më u vendosur në Mars të këtij viti unë që sigurisht që jam ngutur sepse duhet më e marrë edhe ligjshmërinë nga **Ministria Pushtetit Lokal** dhe nga **Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor** dhe i kam thirrur dhe ju kam thënë se që kjo është mundësia tash. Mundësia tjetër ja u kam propozuar unë , nuk ka propozuar askush atë vend , unë e kam propozuar dhe kërkoj nga ju më e votua , ka qenë që nuk mundemi më e bërë tash. Edhe shtatoren e Fehmi dhe Xheve Lladrovci edhe të Adem Jasharit ,

Hamëz Jasharit ,Shaban Jasharit edhe të Iliaz Kodrës kemi me u detyrua më i heqë përkohësisht derisa ta bëjmë tunelin dhe sheshin ashtu si i ka hije. Më punën që e kemi bërë kemi fituar mjetet dhe do ti fitojmë edhe do të marrim edhe grande tjera me ndërtua. Asgjë keq nuk kemi më lenë. Por shtatorët që kemi ndërtua dhe shtatorët që do ti ndërtojmë e do ti ndërtojmë me mjete të vetë donatorëve se akoma nuk kemi bërë shtatore më mjete të buxhetit të Komunës ose të buxhetit të nivelit qendror përkundër asaj që shumë komuna edhe qeveria ka bërë veprime të tilla ku i kanë shpenzuar mjetet e taksapaguesve për ndërtimin e shtatoreve , ndërsa ne i kemi bërë pa e shpenzuar asnjë cent dhe kam thënë që për aq kohë sa jam Kryetar Komune nuk ka më shpenzuar Komuna buxhet të vetin për më i ndërtua shtatorët ose monumentet tjera. Ndërsa prej nivelit qendror do mundohem të fitojmë mjete për shtatorët që do të behën në të ardhmen. Kështu që edhe një herë ju kërkojë që ta votoni propozimin tonë por ndoshta e ka fjalën edhe propozuesi i parë që të marrim vendim ,nëse në fjalën përfundimtare të tij.

Florentina Elezi – Përshëndetje për të gjithë. Unë edhe në Komitetin për Politike dhe Financa e kam shprehur mendimin tim në lidhje me shtatorët. Fatkeqësisht fjalët që i kam thënë atje nuk po shoh ndonjë reflektim së prape po shihni më një fare forme me i hodh ata persona që po flasin jo kundër shtatoreve por ndoshta po mendojnë që shtatorët nuk janë e vetmja mënyre për me e respektua luftën e UÇK-së ose vlerat e saj. U panë shumë fjale prej juve në drejtim të kolegëve vetëm pse e shprehen mendimin e tyre një fare forme mos pëlqimin e teprimit më shtatore. Edhe unë po mendoj që herën kaluar nuk i kishim votua ato shtatorë që janë tashme në shesh. Më fjalë prej anës juaj kinse ne nuk e vlerësojmë luftën e UÇK-së ose jemi kundër ose po na mundojnë shumë shtatorët e ushtarëve ose komandantëve të UÇK-së. Unë po mendojë që më shtatore u bë mjaft as ato që janë aty ndoshta po them edhe një here se nëse e kishim pas guximin me fol pa na etiketua si tradhtarë nuk i kishim votuar dhe sot nuk do te ishin në shesh , përveç shtatores së Fehmi dhe Xheve Ladvocit , për tjera nuk po mendoj që ka pas nevojë. As tash unë jam kundër shtatoreve sepse mendojë që luftën e UÇK-së edhe vlerat e komandantëve dhe atyre që e kanë jap jetën për liri mundemi me i vlerësua edhe me i mbrojtë në mënyra tjera e jo duke ndërtua shtatore. Jetojmë më një vend më falni por nuk kemi ujë të pijshëm po jetojmë sikur në shekullin e nëntëmbëdhjetë (19). Po mendoj që më mirë ato donacione më i marrë dhe më e rregullua mirëqenien e qytetareve sesa më ndërtua shtatore sepse po thamë edhe një here që nuk është e vetmja mënyre për me i vlerësua ushtarët që e kanë jep jetën për liri ose ata që na kanë ndihmuar që i propozoi kolegu Petrit Gashi. Kam respekt tepër të madh për secilin person që ka jep jetën për liri edhe atyre që na kane ndihmuar. Gjithashtu kolegu Adem Bucolli tha se unë kam të drejtë më shumë se ju tjerët me fol për luftë ndoshta sepse ka qenë luftëtarë por unë po them që secili që jemi këtu në sallë por edhe ata qytetarë që nuk janë këtu jemi të prekur prej luftës qoftë në mënyrë direkte apo në mënyrë indirekte , asnjë nuk kemi shpëtuar lehte prej luftës , të gjithë i bartim pasojat qoftë mungesa e prindit qoftë mungesa e nënës , e vajzës e djalit e familjareve më të largët , të gjithë i kemi pasojat. Ju lus që të mos bëjmë debate dhe të mos armiqësohemi më njeri-tjetrin për të cilët ata po bëjmë debat e kanë jep edhe jetën e vet për lirinë që ne e gëzojmë sot. Për sheshin pajtona edhe unë që më rrit sheshin , ndoshta kjo ndihmon në zhvillimin ekonomik në hapjen e bizneseve mos të harrojmë që po largohen shumë qytetarë prej Drenasit

për shkak se jeta është shumë e vdekur , nuk kemi jetë aktive në Drenas , nuk kemi aktivitete , kinema , teatër. Për këtë arsye po ikin qytetaret e Drenasit , po shkojnë në Fushe Kosove ose në Prishtinë sado mundohemi me e mohu. Ju lus ato donacione që po më vjen mirë po mundeni me i marr më i shfrytëzua për diçka tjetër më u a lehtësua jetën edhe mirëqenien tone e jo ndërtimin e shtatoreve se nuk është rruga e vetme dhe mënyra e vetme për vlerësimin e vlerave të luftës dhe të atyre personave.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci**- Zonja Elezi te jemi te qartë sheshin edhe vazhdimin e sheshit edhe tunelin për lëvizjeve te makinave e kemi te domosdoshëm dhe mjetet do te përdoren për atë qellim. Nuk thashë qe kanë me u përdorë për shtatore. Donacionet e miqve , shokëve tanë privat. Donacionet nuk ti jep askush për me sigurua ujë. Nëse po mendoni qe nuk kemi ujë tash për shkak te turbullirave shkak i vërshimeve është çështje tjetër. Nëse po mendoni qe nuk kemi ujë shkak i mjeteve është e pavërtetë sepse në mjete kemi pas duke zhvilluar projekte, kurrë nuk te kam dëgjuar duke thënë që Komuna ka hap 3/4 herë tenderë dhe i ka shpallë, i ka pagua dhe i ka pranuar teknikisht dhe nuk e keni ngritë zërin asnjëherë. Unë i kam ndjekur te gjitha procedurat janë ne prokurori.

Adem Bucolli - Unë nuk e përvetësova UÇK-në por unë e thashë me humor për atë se kam më shumë të drejtë , se këtu faktikisht jemi te gjithë të barabartë se kemi qenë te barabartë ne luftën e shenjte të UÇK-së , dikush me pushke e dikush me ujë e dikush me buke . Por qa po me dhemb me se shumti kundërshtimi i yt për shtatore se ata janë vula e lirisë si po thua nuk ka pas nevojë me qene shtatorja e Adem Jasharit ne sheshin tone.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz Lladrovci**- Te gjithë dëshmorët janë te njëjtë madhësia e tyre , vepra e tyre dallon për ka funksioni , mosha dhe puna. Mos provoni me ma hodh qe unë po i beje 5/6 shtatore dhe po i hidhërojë 200 familje. Kam thënë dhe po thamë prapë dyqind shtatore kemi me ja u gjet vendin qofte se kemi me gjetë mjete, donator jashtë buxhetit komunal kështu dhe jashtë buxhetit tjetër, qe unë ka me ju gjet vend te gjithëve veç a ka kush qe i ndërton.

Petrit Gashi – Faleminderit për debatin. Ne fakt këto ishin vetëm propozime të cilat ne nuk ja qitëm vulën që me i vendosë . Ishin propozime dhe nuk e thashë rastësisht replikën me kolegun Beçir Kiqina qe Drenasi është zemra e Kosovës jo për shkak te aktiviteteve te UÇK-së edhe aksioneve te para por për shkak se çdo qytetar i cili ka qene i lindur para vitit **1999**, ka jep kontribut te jashtëzakonshëm ne Drenas edhe ai fëmija ne djep se edhe aj fëmija është mall tretuar prej një vendi ne vendin tjetër , secili ka qenë kontribuues secili dëshmorë dhe secilit i përkulemi . Ndoshta te ardhmën mund ta bëjmë një edhe një shtatore me te gjithë emrat e tyre midis sheshit , dhe desha ti kthej përgjigje kolegut tim z. Bedri Nika, por mendoj qe figura e Adem Demaçit i përmbledhë komplet atë pjesën e historisë te cilët kane dhëne kontribut te jashtëzakonshëm edhe tjerët. Dy figurat qe i propozova , dy qe kane ndihmuar çlirimin mos të harrojmë se nuk janë vetëm Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara te Amerikës qe kanë ndihmuar luftën e UÇK-së dhe çlirimin e saj por kane qenë këto dy figura kryesore qe kane berë

ndihmuar luftën e UÇK-së dhe çlirimin e saj por kane qene këto dy figura kryesore qe kane bere me intervenua Bashkësia Ndërkombëtare dhe NATO , i propozuam dhe dy te cilat e sollën Pavarësinë e Kosovës te cilën e caktuan edhe datën kur me shpall sepse ne ishim te pafuqishëm karshi botes për me marr vendime vet dhe na kane ndihmuar. Sot nuk po ja qesim vulën por sot po kërkoj përkrahjen e juaj në mënyre qe këto te vendosen dhe besoni qe nuk e devijojnë historinë por vetëm sa e pasurojnë atë.


Fjalën e merr Kryetari i Komunës **Ramiz LLadrovci** – Sa i përket propozimit te kryesuesit te kuvendit komunal z. **Labinot Halilaj** është propozim i duhur për sheshin por propozimet i keni komisionin janë anëtarët për emërim te shesheve te rrugëve e te institucioneve tjera.; Unë ka me ju sjelle edhe një propozim kur po flasim për luftën. Javier Solana ka qene sekretar dhe ka me ja propozua komisionit emrin e një rruge edhe me emrin e tij sepse ka qene Javier Solana ka qene ai qe e ka dhëne urdhrin. Nuk po thamë shtatore por një emër sepse e nderon luftën e UÇK-së edhe lirinë e Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj;kalojmë tek pik e pestë ,5. Të ndryshme;

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.


Mbledhja përfundoj rreth orës: 12:00. min.

Procesmbajtëse:


Zahir Podrimqaku Subashi



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit

01. Nr 353/02-6833 dt, 12/02/2021

Në bazë të nenit 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 par (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 pika 1.2 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenit 3 pika 1.14 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, Aktvendimit Nr.08-353/02-6741, të datës 12.02.2021, të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, për leje të lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit Asllan Fazliu, në zonën kadastrale Drenas në parcelën nr. P-778-4, Raportit Nr.01-020/04-6458, të datës 12.02.2021, të komisionit për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu, Raportit Nr.07-052/01-6761, të datës 12.02.2021, të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për caktimin e lokacionit, për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit “Asllan Fazliu”, i plotësuar

I

Të MIRATOHET Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit “Asllan Fazliu”, zona kadastrale Drenas në parcelën nr. P-778-4.

II

Qëllimi i këtij vendimi është të bëhet caktimi i lokacionit në pronë komunale, përcaktuar nga ana e komisionit, në të cilën do të bëhet vendosja e shtatores, pas ndërtimit të sheshit që parashihet në atë pjesë.

III

Të gjitha shpenzimet sikurse për punimin e shtatores ashtu edhe për vendosjen e bazamenteve do të bëhet me anë të donatoreve.

IV


Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore.

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

VI

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MPL-së.



Arsyetim

Ne përputhje me kërkesën e Ministrisë së Pushtetit Lokal, rrjedhimisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Komuna e Drenasit ka ndërmarr veprimet konkrete me qëllim të harmonizimit të vendimit të Kuvendit të komunës me kërkesën e MEA-së.

Duke pasur parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorit të Kombit për çlirimin e vendit, Komuna e Drenasit cakton lokacionin për vendosjen e shtatores së heroit "Asllan Fazliu".

Familja Fazliu, ka ndërtuar shtatoren e heroit "Asllan Fazliu" me kontributin e familjes dhe bashkëluftëtareve të heroit, ndërsa Komuna e Drenasit merr për obligim caktimin e lokacionit për vendosje të shtatores.

Familja është pajtuar me rekomandimin e kryetarit të komunës, që të pritët deri në përfundim të ndërtimit të sheshit që parashihet të ndërtohet në parcelën P-778-4, në mënyrë që atë të vendoset shtatorja.

Andaj, vendosja e shtatores në parcelën nr. P-778-4, në zonën kadastrale në Drenas, është bërë me propozimin e Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci dhe dakordimin e plotë të familjes Fazliu, pas komunikimeve zyrtare të shkëmbyera si dhe takimit të zhvilluar me datë 28.01.2021.

Familja Fazliu dhe Institucioni i Komunës së Drenasit të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës janë pajtuar që vendosja e shtatores së heroit të kombit "Asllan Fazliu", në parcelën 778-4, do të bëhet pas përfundim të sheshit i cili parashihet që të ndërtohet në 2-3 vitet e ardhshme.

Të bashkangjitur gjeni të gjitha dokumentacionin në lidhje me këtë çështje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT: P-70315016-00778-4

Numbri i fildës / Broj Predmet / Case Referent Number: Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: Komuna / Opština / Municipality: Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC	29/01/2021/21 29.01.2021 - 09:17 GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC Glogoc / Glogovac / Glogoc
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numbri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vista Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vista imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrimi Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315016-00778-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urbana	1378	0072-86		28.01.2020

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostil adrese Address Details	Azhuruar Ažurirano Updated
ASHANQJEC/VASHANQJEC/VASHANQJKA		ASHANQJKA	28.01.2020




A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shtfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasesë Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina Area
1	Tokë Ndërtimore/Grafcjevinako zemijfite/Construction land	Trrall/Zemliste/Land		1378

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurnano Updated
Posestfim individuali/ Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC /		FEHIMI DHE XHILVË LLADROVCI	1/1	0072-86	





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gillogoc

Njësia/Jednica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70315016-00778-4	Parcelë / Parcela / Parcel	1378



Shkalla/Razmera/Scale: 1:704

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 29.01.2021

Koha/ Vreme/ Time: 09:17:51

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojito/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr.020/04-6458 dt.12.02.2021

DATE/DATUM/DAT:	12.02.2021
PËR/ZA/TO:	z.Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Komisioni për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu.
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	RAPORT

RAPORT

Komisioni për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës 01-Nr.020/04-6458, dt.11.02.2021, në përbërje të plotë:

1. Besart Bajrami- (Kryetar)
2. Shaban Dobra- (Antarë)
3. Liridona Durmishi-(Antarë)


Me datë 11.02.2021, ka filluar punën e vetë lidhur me përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu në parcelen kadastrale P-70315016-00778-4, zona Kadastrale Glllogoc.

Komisioni mori në shqyrtim materialet e nevojshme për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit duke u bazuar në nenin 3 pika 1.14 të Ligjit nr.04/L-110 për Ndërtim, nenit 5 pika 1.2 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në bazë të Vendimit Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028 të komuës së Glllogocit me 12-Nr-400/01-28767, të datës 30.07.2020, Vendimi mbi emrimin e Sheshit "Fehmi Lladrovci" Nr.031-2557 dt.04.05.2009, dhe doli në teren për të bërë përcaktimin e lokacionit.

Pas analizave të bëra në teren, ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës që lidhen me fushën e Ndërtimit dhe Planifikimit si dhe planeve hapsinore të Komunës të cilat janë në fuqi, komisioni përcakton lokacionin në parcelë për vendosjen e shtatores sipas skicës (ortofoto).

Fillimi i punimeve për vendosjen e shtatorës të bëhet pas përfundimit të punimeve në rregullimin dhe zgjerimin e sheshit të cilat përfshijnë edhe parcelën në të cilën është planifikuar vendosja e saj.

Bashkangjitur me këtë raport gjeni pozitën e vendosjes së shtatores në kuadër të sheshit "Fehmi Lladrovci".



Komisioni

1. Besart Bajrami

2. Shaban Dajana

3. Liridon Garmishi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT



Nr. 01-360/01-6835 dt. 12.02.2021

Në vështrim të nenit 14.2 dhe 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1.neni 4 pika 1.1.neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, dhe Vendimit Nr. 12-020-11267 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, Raportit Nr.06-020/04-6276, të dt.02.10.2021 dhe Rekomandimit Nr. 06-020/04-6276, të dt.11.02.2021 të këtij komisioni, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr.12/360-68569, të dt. 29.11.20219 të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënie në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social

Neni 1

1.1. Shfuqizohet pika 1 e nenit 2 të Vendimit Nr.12/360-68569, të dt. 29.11.20219 të Kuvendit Komunal për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të Banesës me Nr. 14, Kati i II-të, në Blloku I në Drenasin III, për znj. Bahtije Feka.

1.2. Shfuqizohet pika 2 e nenit 2 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të Banesës me Nr. 2, Llam. B.P., Blloku II në Drenasin III, për znj.Hajrie Makolli.

1.3. Shfuqizohet pika 3 e nenit 2 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të Banesës me Nr. 9, Kati III-të/A, në Bllokun II në Drenasin III, për znj. Hava Deliu.

Neni 2

Lejohet lidhja e kontratave për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të banesave të caktuara me qira joprofitabile në Bllokun I dhe II në Drenasin III, me këta përfitues të rinjë të cilët kanë bërë kërkesa për strehim:

2.1. Banesa me Nr. 9, Kati i III-të/A, në Blloku II, i ipet në Shfrytëzim të Përkohshëm, (me kohë të caktuar, përkatësishtë deri në thirrjen publike të ardhshme për aplikim), z. Ardian Uka nga fshati Gradicë.

2.2. Banesa me Nr. 14, Kati i II-të, në Blloku I, i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), znj. Kifete Gjeli- nënë

kryefamiljare, përkatësisht të transferohet nga Banesa me Nr. 1, Përdhesë/A, në Bllokun II, (banesë teknikishtë e pabanueshme), në banesën e lartëcekur.

2.3. Banesa me Nr. 2, Llam. B.P., në Bllokun II, i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), znj. Fatbardha Muja- nënë kryefamiljare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Propozim-Vendimi obligohet Kryetari i Komunës duke nënshkruar kontratat me qira joprofitabile për shfrytëzimin e përkohshëm të banesave sociale më përfituesit bazuar në rekomandimin e Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal-Drenas.

Neni 4

Me këtë Propozim -Vendim do të njoftohen: Drejtoratët e Komunës së Drenasit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë dhe një mbetët për evidencë.

Neni 5

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Më Ligjin Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim Social 2019-2021, me Vendimin nr.12-020-11267 të datës 27.02.2019 është formuar Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm.

Gjatë punës së vet Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social është angazhuar maksimalisht që këtë mision ta kryej me nderë dhe përgjegjësi të lartë, duke bashkëpunuar me të gjithë akterët relevant për ta jetësuar në përpikmëri këtë mision të tij.

Marrë parasyshë faktin se **në Bllokun I dhe Bllokun II, në Drenasin III**, të Banimit të Përkohshëm Social janë gjithësej **50 banesa**, **46** prej tyre janë duke u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit e përcaktuar me kontratë, në mënyrë të rregullt, ndërsa **4** jo. Rrjedhimisht, nga kjo që u tha më lartë, konstatohet se në Banesat në **Bllokun I** dhe në **Bllokun II** të Banimit të Përkohshëm Social, faktikisht janë të lira këto banesa:

Banesa me nr 14, Kati i II-të, në Blloku II, e cila i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm znj. **Bahtije Feka**, me të cilën është lidhur kontrata me Nr. 01/360-25959 e dt. 16.11.2020 në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019 për dhënjen në shfrytëzim të banesës së lartëcekur, mirëpo e njëjta nuk e ka marrë kopjen e kontratës, përkundër thirrjeve telefonike nuk është lajmëruar, gjithashtu sipas konstatimeve të komisionit për verifikimin e banimit të përkohshëm social nuk është vendosur fare në banesë, pra nuk është duke banuar, (evidentimi i komisionit për verifikim të gjendjes së banesave në tri (3) procesverbale), gjë që e ka humbur të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese.

Banesa nr. 9, Kati III/A në Bllokun II, i është dhënë në shfrytëzim znj. **Hava Deliu**, e cila e ka nënshkruar kontratën, me Nr. 01/360-25953, me dt. 16.07.2020, në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, mirëpo nuk e ka marrë kopjen e kontratës dhe gjithashtu nuk është vendosur fare në banesën e lartëcekur, përkundër thirrjeve telefonike nuk është lajmëruar, gjithashtu komisioni në përbërje të plotë e ka verifikuar gjendjen faktike dhe ka konstatuar se banesa është e mbyllur dhe faktikisht nuk është duke banuar

askush, (evidentimi i komisionit për verifikim të gjendjes së banesave në tri (3) procesverbale), gjë që e ka humbur të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese.

Banesa me Nr. 2, Llam. B.P., Blloku II, me vendim të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, i është ndarë në shfrytëzim znj. **Hajrie Makolli** për shkak të gjendjes ekonomike të rëndë, mirëpo e lartëcekura nuk ka pranuar të nënshkruaj kontratën dhe ka dhënë deklaratë me shkrim për refuzimin e banesës në fjalë, që do të thotë se e njejta vullnetarishtë ka hequr dorë nga shfrytëzimi i banesës në fjalë.

Banesa nr. 1 përdhësë/ A në Bllokun II, me vendim të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm **Kifete Gjellit**- nënë kryefamiljare (me të cilën është lidhur kontrata me Nr. 01/360-25962, me dt. 16.07.2020, për shfrytëzimin e përkohshëm të banesës. (banesë që aktualishtë është teknikisht e pabanueshme).

Marrë parasyshë gjendjen aktuale Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social vendosi që të zhvilloj procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, përkatësishtë në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veqanta të Banimit dhe Udhëzimeve Administrative, përkatësishtë bazuar në nenin 13 të tij lidhur me shkëputjen e kontratës së qirasë, ku thuhet se “Organi kompetent komunal, shkëput kontratën për qiranë në rastet kur: 1. Qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejtshëm për të ardhurat, 2. Qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk ka njoftuar organin kompetent komunal. Gjitashtu Neni 8 i Kontratës mbi Shfrytëzimin e Përkohshëm të Banesës me Qira Joprofitabile, të lidhur me dt. 16.07.2020, në mes të Komunës së Drenasit dhe pales përfituese, thotë “Qiradhënësi ka të drejtë të shkëpusë kontratën nëse qiramarrësi i shkel kushtet e kontratës”.

Andaj propozojmë që të bëhet shfuqizimi i pikës 1. 2 dhe 3 të Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019 për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, këtyre përfituesve të Shfrytëzimit të Përkohshëm Social:

1. Bahtije Feka, për Banesën me nr 14, Kati i II-të, në Blloku I,
2. Hava Deliu, për Banesën me nr. 9, Kati i III-të/A, në Blloku II,
3. Hajrije Makolli për Banesën me Nr. 2, Llam. B.P., Blloku II, për znj. Hajrie Makolli.

Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, verifikoj gjithashtu dokumentacionin e të gjitha kërkesave për strehim të evidentuara deri me sot, dhe sipas kritereve përzgjedhi disa nga to t'i vizitoj në teren. Përzgjedhja është bërë nga lista e pritjes së familjeve të cilat kanë aplikuar për zgjidhjen e problemit të banimit, përkatësisht për strehim, në bazë të kritereve të përparësisë të parapara në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, si statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti si dhe struktura e familjes. Pas vizitave në teren të datës 21.01.2021, Komisioni na rekomandoi që **Banesa me nr. 9, Kati III/A në Bllokun II**, t'i ipet për banim të përkohshëm familjës së **Ardian Ukës**, nga fshati **Gradicë**, Komuna e Drenasit. Kjo familje jeton në një shtëpi të vjetër në kushte të vështira socio-ekonomike. Kjo familje ekzistencën e vet e siguron nga ndihma sociale (evidentimi i komisionit në teren gjendet në procesverbal). Vlen të veqohet se me datën 25.01.2021 Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, ka vizituar në teren familjen e **Fatbardha Mujës**, e cila rreth dy javë më heret është vendosur me familjen e saj katër anëtarëshe në **Banesën me nr. 2 Llam.B.P., Blloku II**, në kuadër të banesave për Banim të Përkohshëm Social në Drenasin III. Familja e **Fatbardha Mujës** nga fshati **Fushticë e Ulët**, Komuna e Drenasit, është vendosur në këtë Banesë (me desitnim për afarizëm), për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike. Kjo familje katër antarëshe ekzistencën e vet e siguron nga ndihma sociale. Andaj propozohet që për hire të gjendjes së vështirë socio-ekonomike të familjes së **Fatbardha Mujës**- nënë kryefamiljare t'i njihet e drejta sipas dispozitave ligjore për shfrytëzim të banesës së lartëcekur, (evidentimi i komisionit në teren gjendet në procesverbal).

Pra nga kjo që u tha më lartë propozojmë që të lejohet lidhja e kontratave për dhënien e banesës me qira joprofitabile me këta përfitues të rinjë të cilët kanë bërë kërkesa për strehim:

1. **Banesën me nr. 9, Kati i III-të/A, në Blloku II**, t'i ipet në Shfrytëzim të Përkohshëm, (deri në thirrjen publike të ardhshme për aplikim), **z. Ardian Uka**.
2. **Banesa me nr 14, Kati i II-të, në Blloku I**, t'i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), **znj. Kifete Gjeli**- nënë kryefamiljare, përkatësisht të transferohet nga Banesa me Nr. 1, Përdhesë /A, në Bllokun II, tek banesa e lartëcekur, për shkak se është banesë teknikishtë e pabanueshme.
3. **Banesa me nr. 2, Llam.B.P., në Bllokun II**, t'i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), **znj. Fatbardha Muja**- nënë kryefamiljare.

Ndërsa për **Banesën me nr. 1, Përdhesë/A, në Blloku II** për të cilën theksuam se është teknikisht të pabanueshme, nuk rekomandojm të vendoset ndonjë familje për shkak të mungesës së kushteve të përshtatshme për banim, për të cilën shpresojmë që do të bëhet ndonjë investim.

Ky propozimvendim vie në përputhje me dispozitat ligjore në mënyrë që të arrihet qëllimi i Programit të Banimit të Përkohshëm Social dhe tu mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike ta zgjidhin këtë problem.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit



Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

08-Nr 353/02-6741 dt. 12/02 2021

Në bazë të nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.14 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 44 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në bazë të Vendimit 12-Nr.400/01-28767 të datës 30.07.2020, i miratimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Glllogocit për periudhën 2020-2028, nenit 8 mbi ndryshim plotësim të Statutit të Komunës së Glllogocit, Raportit 01-Nr.020/04-6458 dt. 12.02.2021 të Komisionit për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit Asllan Fazliu. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në bazë të detyrës zyrtare me datë 12.02.2021, merr këtë:

AKTVENDIM

I. Më këtë aktvendim Komunës së Glllogocit i jepet leje e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit Asllan Fazliu në parcelën kadastrale P-70315016-00778-4 zona kadastrale Glllogoc.

II. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit me datë 12.02.2021, duke vendosur sipas detyrës zyrtare merr aktvendim me të cilën Komunës së Glllogocit i jepet leje e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit Asllan Fazliu në parcelën kadastrale P-70315016-00778-4 zona kadastrale Glllogoc. Duke u bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur në lëndë siç është Vendimi 12-Nr.400/01-28767 të datës 30.07.2020 i miratimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Glllogocit 2020-2028, vendimin Nr.031-2557 të datës 04.05.2009 mbi emërtimin e sheshit të qytetit të Drenasit me emrin e heroit të kombit "Fehmi Lladrovci", Raportit 01-Nr.020/04-6458 dt. 12.02.2021 të Komisionit për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit Asllan Fazliu, skicën ku është paraparë të vendoset shtatorja e Heroit Asllan Fazliu dhe bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Ky aktvendim shërben për leje të lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit në sheshin "Fehmi Lladrovci", sipas skicës që është pjesë e këtij aktvendimi ndërsa për qëllime të tjera i njëjti nuk mund të përdoret.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

F. A

Aktvendimi i'u dërgohet:

- Komunës së Glllogocit;
- Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Arkivit;

Lëndën e përpiloi:
Flora Krasniqi

Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



DATE:	12.02.2021
NUMËR:	
PËR/ZA/TO:	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Prishtinë
PËRMES:	Kryetarit të Komunës së Glllogocit - z. Ramiz Lladrovci
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit, Drejtori: Flutura Avdiu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë



Të nderuar,

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu në parcelën kadastrale 00778-4, zona kadastrale Glllogoc.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka dhënë leje lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu duke i'u referuar dokumenteve aktuale valide të planifikimit hapësinor përkatësisht, Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 (i miratuar me vendim të Kuvendit Komunal 12-Nr 400/01-28767 të datës 30.07.2020), dhe Planit Rregullues Urban "Qendra 1", si dhe vendimit Nr 031-2557 të datës 04.05.2009 mbi emërtimin e sheshit të qytetit të Drenasit me emrin e heroit të kombit " Fehmi Lladrovci ”.

Bazuar në elaborimin e lartëshënuar mbi bazueshmërinë, përputhshmërinë dhe mbulueshmërinë me Planin Zhvillimor Komunal si dhe trajtimin e lokacionit/parcelës aktuale në aspektin e ndërlydhjes konstatohet se, kjo parcelë kadastrale hynë brenda kufirit ndërtimor- urban e paraparë sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Rregullues Urban "Qendra 1".

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



DATE:	12.02.2021
NUMËR:	
PËR/ZA/TO:	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Prishtinë
PËRMES:	Kryetarit të Komunës së Glllogocit, Kamiz Edhevc
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit, Drejtori: F. Haxhiu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Sqarime shtesë

Të nderuar,

Duke u bazuar lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit për vendosjen e shtatores së heroit Asllan Fazliu në parcelën kadastrale 00778-4 zona kadastrale Glllogoc.

Komuna e Drenasit sqaron se, realizimi i projektit të vendosjes së shtatores së heroit Asllan Fazliu, nuk është planifikuar me buxhet të Komunës mirëpo do të realizohet me donator dhe në zbatim të dokumenteve të planifikimit hapësinor siç janë Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028, në kornizën e zhvillimit hapësinor dhe Planit Rregullues Urban Qendra 1 në Drenas.

Bashkëngjitur gjeni Planin Rregullues Urban Qendra 1 në Drenas.

Me respekt!





REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Komuna Drenas/Glllogoc
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



Nr. 07 - 052/01-6761

dt. 12/02/2021

DATE/A:	12.02.2021
PËR/ZATO:	Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
PËRMES:	Ruzhdi Lestrani, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë 
NGA:	Isak Bytyqi, Shef i Sektorit të Pronës dhe Pronë 
TEMA:	Raport



Të ndëruar/a,

Në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, nr 08-070/01-6739, të dt, 12.02.2021, si dhe duke u bazuar në në Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit të vitit 2020-2028, Planit Rregullues Urban (PRrU) Qendra 1, pjesët e njësive kadastrale P-70315016-00778-4 zona kadastrale Glllogoc pronë komunale, gjenden në zonën Qendra 1 të Glllogocit, në të cilën me Plan Zhvillimor të Komunës dhe me Plan Rregullues Urban (PRrU) është planifikuar zonë ndërtimore.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, konkretisht Sektori i Pronës mbas evidentimit të të gjitha pronave të Komunës së Glllogocit, ka ardhur në përfundim se nuk ka ndonjë pronë/parcelë tjetër të përshtatshme të Komunës së Glllogocit, për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu.

Prandaj parcela 778-4, në zonën kadastrale Glllogoc, pronë komunale është e vetmja parcelë që i plotëson kushtet për realizimin e këtij projekti, komkretisht vendosjen e shtatorës së Heroit të Kombit Asllan Fazliu.

Me respekt!